



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT**

**V E N D I M**

Nr. 13, datë 27.11.2024

**PËR  
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “TREESCAPE, GODINË  
BANIMI DHE HOTELERIE 7 KATE ME 1 KAT NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE  
NË VELIPOJË, BASHKIA SHKODËR**

Në mbështetje të neneve 27, 28, 39 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “New Era Construction” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Treescape, Godinë banimi dhe hotelerie 7 kate me 1 kat nëntokë”, me vendndodhje në Velipojë, Bashkia Shkodër, me subjekt zhvillues shoqërinë “New Era Construction” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë i bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
  - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Shkodër.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Ministria Turizmit, Kulturës dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi, pasi nënshkruhet nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit, hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**EDI RAMA**



MINISTËR I LINJËS  
MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT  
BLENDI GONXHJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKT  
DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT  
ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 30/09/2025